

Manual “Si të ktheni idetë tuaja në Projekte Evropiane?”

Manual i FP7

EU-BALKAN-FABNet

Indeksi

KAPITULLI I: CFARË OFROHET NGA BASHKIMI EVROPIAN?.....	5
1.1 Hyrje në programin e kërkimit të Bashkimit Evropian.....	5
1.2 Çfarë është FP7?.....	5
1.3 Çfarë iu ofrohet kërkuesve të sektorit agroushqimor?	7
1.3.1 Bashkëpunimi (Kërkimi bashkëpunues)	7
1.3.2 Kërkimi për SMEs	11
1.3.3 Kërkimi Potencial (RegPot)	14
1.3.4 Njerëzit.....	18
1.3.5 Idetë.....	23
KAPITULLI II: SI PUNOHET?	26
2.1 Cilat janë parimet e përgjithshme?.....	26
2.1.1 Komisioni Evropian paraqit thirrjet për propozime.....	26
2.1.2 Aplikantët përgatitin propozimet.....	27
2.1.3 Vlerësimi i propozimeve.....	28
2.1.4 Negocimi	29
2.1.5 Implementimi i projektit.....	29
2.1.6 Raportimi.....	29
2.2 Çfarë lloj projektesh?.....	30
2.3 Kush mund të marrë pjesë.....	31
2.4 Çfarë financohet?	31
2.5 Si mund të gjesh mundësi?	31
KAPITULLI III: SI TË MARRËSH PJESË?.....	35
3.1 Përgatitni propozimin tuaj.....	35
3.1.1 Si të veproshh?.....	35
3.1.2 Si të gjesh partnerë?.....	35
3.1.3 Si të shkruash projektin?.....	37
3.1.4 Faktorët për sukses.....	40
3.1.5 Pas mbajtjes.....	41
3.2 Negocimi i projektit tuaj.....	42
3.2.1 Si të vepronit?.....	42
3.2.2 Faktorët për sukses.....	44
3.3 Implementimi i projektit tuaj.....	45
3.3.1 Regulla bazë.....	45
3.3.2 Faktorët për sukses.....	45
3.3.3 Pas projektit.....	45

KAPITULLI IV: PROJEKTET AGROUSHQIMORE, KËSHILLA TË PËRGJITHSHME DHE SHEMBUJ TË DETAJUAR.....	46
4.1 Shembull i projekteve agroushqimore.....	46
4.2 Çfarë janë objektivat e EU-Balkan-FABNet dhe grupet e synuara.....	47
4.3 Partnerët e projektit EU-Balkan-FABNet.....	48
ANEKSE	50
A. 1 Fjalor	50
A.2 Adresat e përdorura.....	53

Hyrje e përgjithshme

Manuali “Si të ktheni idetë tuaja në Projekte Evropiane” është një udhëzues i Programit Kuadër 7 për Kërkim dhe Zhvillim (FP7). Ai është përgatitur në kuadrin e Projektit EU-Balkan FABNET, një Veprim me Mbështetje të Veçantë, i financuar nga Programi Kuadër 6 (FP6).

Objektivi kryesor i këtij manuali është të ndihmojë pjesëmarrjen e kërkuesve nga Vendet e Ballkanit Perëndimor në projektet e kërkimit të agroushqimor nën FP7. I shkruar për kërkuesit e sektorit agroushqimor, ky manual siguron informacionin e nevojshëm për të aplikuar një projekt FP7 që të plotësojë nevojat e kërkuesve (trainime individuale, rritje kapaciteti ose projekte kërkimi).

Në kapitullin e parë, manuali paraqet pesë programet më interesante të përshtatshme për kërkuesit agroushqimorë brenda FP7. Kapitulli i dytë jep një pamje të përgjithshme të FP7: mekanizmin dhe hapat kryesorë të një projekti, burimet e informacionit, pjesëmarrësit potencialë dhe vlerat e financimit. Kapitulli i tretë siguron informacion dhe faktorët e suksesit për çdo hap të ciklit të kohëzgjatjes së projektit, nga përgatitja deri në fund të projektit. Shembujt konkretë të projekteve të agroushqimit dhe informacioni i detajuar rreth BAFN dhe EU-BALKAN FABNET jepen në kapitullin e fundit.

Manuali 'Si të futni idetë tuaja në projektet Europiane?'

Kapitulli I; Ç'farë ofrohet nga Bashkimi Evropian?

Ky kapitull jep pesë nën programet më interesante të përshtatshme për kërkuesit agrorshqimorë brenda FP7.

1.1 Hyrje në programin e kërkimit të Bashkimit Evropian.

Megjithëse disa shembuj të bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik gjenden që në Mesjetë, puna kërkimore në Evropë është kryer kryesisht në nivel kombëtar deri në mes të shekullit të njëzetë.

Urgjenca për programet dhe institutet kërkimore Evropiane të para, në vitet 1950 përkoi me hapat e para që çuan në ndërtimin e Bashkimit Evropian politik.

Komisioni Evropian organizoi programin e parë në vitin 1984, me qëllim që të përmirësonte koherencën e kërkimit Evropian dhe Zhvillimit Teknologjik dhe të stimulonte bashkëpunimin ndërkombëtar.

Traktati i Lisbonës, i Marsit 2000, i Bashkimit Evropian nxorri nevojën për një program kuadër (art.180-Zhvillimi Teknologjik Kërkues dhe Hapësira) dhe vërejti se Evropa do të bëhej në dekadën e ardhshme ekonomia më kompetitive e bazuar në dijet në botë.

Programi Kuadër (FP6 për periudhën 2002-2006 dhe FP7 për 2007-2013) është një nga instrumentat kryesorë që mundësojnë Komisionin Evropian të arrijë objektivat e Lisbonës për BE. që "ekonomia të bëhet dinamike me e konkurrueshme, bazuar në dijet në botë". Veçanërisht, FP synon të transformojë konceptin e Zonës së Kërkimit Evropian në realitet, duke reduktuar kufijtë e kërkimit Evropian dhe duke përmirësuar bashkëpunimin midis programeve kombëtare.

1.2 Ç'farë është FP7?

FP7 përcakton prioritetet për fondet e kërkimit dhe instrumentet financiare, që janë të shoqëruar me këtë fond për periudhën 2007-2013, duke patur në mendje konkurrencën e BE dhe mbështetjen për të bërë politikën.

Mbështetja për aktivitetet e zhvillimit teknologjik dhe kërkimit sigurohet përmes:

- Financimit të projekteve kërkuese të kryera nga kompanitë e përfshira në konsorsium dhe qendrat e kërkimit nga disa vënde
- Mbështetja financiare e ekipeve të kërkuesve të përfshirë në kërkimin bazë.
- Grante individuale që iu jepen kërkuesve më premtues.
- Përmirësimi i kapacitetit kërkues Evropian, duke rritur infrastrukturën e kërkimit dhe duke krijuar rrjete krahinorë të specializuar të qendrave të kërkimit.

Manuali” Sit ë futni idetë tuaja në Projektet Europiane?

Skema e përgjithshme e FP7

Programi Kuadër është ndarë në katër Programe Specifike dhe 13 nën programe:

FP7	Katër Programe Specifike	Nën Programet
	Bashkëpunimi	Iniciativa e teknologjisë së bashkimit Kërkimi Bashkëpunues: 10 Zona Tematike Kordinimi i Programeve Kombëtare Bashkëveprimi Ndërkombëtar Veprimet Mari Kyri
	Idetë Njerëzit	
	Kapacitetet	Infrastrukturat Kërkimi për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme Rajonet e Dijes Potenciali Kërkimor Shkenca në shoqëri Bashkëpunimi Ndërkombëtar Zhvillimi i politikave kërkuese

Për Vendet e Ballkanit Perëndimor nën programet e **Kërkimit Bashkëpunues, Kërkimi për Ndërmarrjet e Vogla** dhe **Potenciali Kërkues** janë me interes të veçantë.

Nën programi për **Kërkim Bashkëpunues** përbëhet nga 10 tema që pasqyrojnë fushat bazë të Teknologjisë dhe Dijes. Ajo përfshin projektin bashkëpunues të drejtuar nga konsorsiumi i organizatave kërkuese.

- 1) Shëndeti
- 2) Ushqimi, Bujqësia, Peshkimi dhe Bioteknologjia
- 3) Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikacionit
- 4) Nanoshkenca, Nanoteknologjitë, Materialet dhe Teknologjitë e Prodhimeve të Reja
- 5) Energjia
- 6) Mjedisi (përfshirë Ndryshimin e Klimës)
- 7) Transporti
- 8) Shkencat ekonomike shoqërore dhe Humanitare
- 9) Hapësira
- 10) Siguria.

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

Nënprogrami Kërkim për Ndërmarrjet e vogla jep mbështetje financiare SME ve të cilat kanë nevojë të nënkontraktjnë aktivitetin e tyre tek qendrat kërkuese ose universitetet, me qëllim që të forcohet kapaciteti i tyre inovativ.

Objektivi kryesor i nënprogramit të Potencialit Kërkues është të stimulojë potencialin kërkues të vendeve antare, duke i dhënë mbështetje qendrave të ekselencës.

Seksioni që vijon siguron më tepër informacion të saktë rreth strukturës të FP7 dhe këshillon sit ë marrësh pjesë në një projekt FP7.

1.3 Ç’farë iu ofrohet kërkuesve ushqimorë?

Ky seksion siguron informacion mbi pesë nën programe, që veçanërisht i drejtohen kërkuesve ushqimorë. Këto pesë nën programe janë:

- Kërkimi bashkëpunues (nën programin e veçantë ‘Bashkëveprim’)
- Kërkimi për SME-të (nën programin e veçantë ‘Kapacitete’)
- Potenciali kërkues (RegPot - nën programin specific ‘Kapacitete’)
- Veprimet Mari Kyri (programi i veçantë ‘Njerëzit’)
- Agjencia e Kërkimit Evropian (programi i veçantë “Ide”)

Çdo paraqitje e nënprogramit ilustron nga një shembull i një projekti konkret. Gjithashtu paraqitet shkalla e suksesit të thirrjes së fundit.

1.3.1 Kërkimi bashkëpunues

Bashkëpunimi – Kërkimi bashkëpunues
Ide - Kërkim në zhvillim
Njerëz – Potencial njerëzor
Kapacitete – Kapaciteti i kërkimit

Në fotografinë sipër; Kapaciteti Kërkues (jo Kapaciteti i Kërkimit)

Objektivat

Kërkimi bashkëpunues synon në zhvillimin e njohurive të reja, teknologjisë së re, produkteve, aktiviteteve demonstruese ose burimeve të përgjithshme për kërkim me qëllim që

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

të përmirësohet konkurrueshmëria Evropiane ose të adresojë nevojat më të mëdha shoqërore. Ato mund të synohen tek grupe speciale, të tilla si: SME-të, dhe aktorë të tjerë më të vegjël.

Buxheti i përgjithshëm i përshtatshëm për Ushqimin, Bujqësinë, Peshkimin dhe Bioteknologjinë (FAFB) për periudhën 2007-2013 është 1 935 million Euro. Ai paraqet një rritje të rëndësishme krahasuar me buxhetin e mundësuar për sektorin agroushqimor në FP6 (prioriteti tematik “Cilësia dhe siguria e ushqimit”, 685 milion Euro nga 2002 deri në 2006, me 178 projekte të financuara.

Objektivat e temës FAFB brenda programit të veçantë bashkëpunues janë:

- Të ndërtojë një **Njohje të Bazuar në Bio - Ekonomi Evropiane Knowledge-Based Bio Economy (KBBE)**

Termi ‘**bio-ekonomi**’ përfshin gjithë industritë dhe sektorët ekonomikë që prodhojnë, menaxhojnë dhe shfrytëzojnë burimet biologjike (të tilla si bujqësia, ushqimi, pyjet, peshkimi dhe industritë e tjera me bio-burime dhe shërbimet e lidhura me furnizimin ose konsumatorët.

- Ti përgjigjet **sfidave shoqërore dhe ekonomike**;
 1. Ushqim me cilësi të lartë dhe prodhim i qendrueshëm ushqimi
 2. Çrregullimet e lidhura me ushqimin (kardiovaskulare, obezitet)
 3. Sëmundjet infektive të kafshëve dhe zoonozoës
 4. Bujqësia e qendrueshme/peshkimi dhe ndryshimi i klimës
 5. Biomaterialet e pastra nga bio-burimet e rinovueshme
- Të përfshijë gjithë mbështetësit (duke përfshirë industrinë) në kërkim
- Të mbështesë Politikën e Përgjithshme Bujqësore (Common Agricultural Policy) (CAP) dhe Politikën e Përgjithshme të Peshkimit (Common Fishery Policy) (CFP)
- Ti përgjigjet me shpejtësi nevojave urgjente të kërkimit (Rreth 70 projekte që synojnë sektorin agroushqimor në vit janë parashikuar të mbështeten).

Në përgjithësi, duhet të jenë të paktën tre “Njësi/ndërmarrje ligjore”, nga Shtetet Antare ose Vendet e Asociuara në BE. Ndërmarrjet duhet të jenë të pavarura nga njëra-tjetra. Një numër i ndryshëm pjesëmarrësish ose pjesëmarrje e disa tipeve organizatash, duhet specifikuar mbi një bazë call-by-call.

Skemat e Fondeve

1. Projekti bashkëpunues (CP)

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

- *Qëllimi:* Zhvillimi i njohurive të reja, teknologjive të reja, produkteve, duke përfshirë koordinimin shkencor. Aktivitetet demonstruese ose burimet e përgjithshme për kërkim,
- *Aktivitetet:* RTD, Demonstrim, të tjera dhe menaxhim.
- *Zgjatja:* 24-60 muaj

3. Rrjetet e Ekselencës (NoE)

- *Qëllimi:* Mbështetje ndaj programit të përgjithshëm të aktiviteteve të disa organizatave kerkuese që i integrojnë aktivitetet e tyre në një fushë të veçantë dhe synojnë në stabilizimin e një partneriteti të qëndrueshëm.
- *Aktivitetet:* aktivitete RTD, të tjera dhe menaxhim
- *Zgjatja:* 48-60 muaj

2. Koordinimi dhe Veprimet Mbështetëse (CSA)

-*Qëllimi:*

- Jo fonde për kërkim, zhvillim ose aktivitete demonstruese. Vetëm aktivitete koordinimi dhe mbështetjeje (të tjera, menaxhim)
- Veprim koordinimi (CA); aktivitete që fokusojnë koordinimin e aktiviteteve kerkuese dhe politikave
- Veprim mbështetës (SA); Normalisht i fokusuar mbi një aktivitet të veçantë dhe shpesh në rrjet dhe ngjarje.

- *Zgjatja:* deri 48 muaj, por zakonisht 12-24 muaj.

Tipet e aktiviteteve të mbështetura financiarisht

- RTD (CP dhe NoE); aktivitete të zhvillimit të kërkimit dhe teknologjik, që reflektojnë aktivitetet bazë të projektit, duke synuar në një përparim të dukshëm, duke përfshirë koordinimin shkencor.

- Demonstrimi (vetëmCP); I projektuar të provojë ecurinë e teknologjive të reja që nuk mund të tregëtohen në mënyrë të drejtpërdrejtë (p.sh. prova e produktit – si prototip)

-Të tjera (CP, NoE dhe CSA)

1. Trainimi i kërkuesve dhe stafit kyç, duke përfshirë menaxherët e kërkimit dhe ekzekutivët industrialë dhe çdo përdorues potencial të njohurive të gjeneruara nga projekti.
2. Shpërndarja: aktivitete për të shpërndarë rezultatet e kërkimit dhe për të përgatitur ngritjen e tyre dhe përdorimin, duke përfshirë menaxhimin e diturive dhe aktivitetet e drejtpërdrejta të lidhura me mbrojtjen e qëllimit kryesor,

- Menaxhimi (CP, NoE dhe CSA)

1. Administrativ
2. Teknik

Aftësitë intelektuale

Për projektet bashkëpunuese (CP), një marrëveshje mbi Aftësitë Intelektuale duhet përfshirë në propozim si pjesë e një Marrëveshjeje e detyruar e Konsorsiumit.

Kriteret e Vlerësimit

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

- Cilësia Shkencore dhe Teknike
- Cilësia dhe Efikasiteti i implementimit të menaxhimit
- IMPACT (Impakt potencial përmes zhvillimit, shpërndarjes dhe përdorimit të rezultateve të projektit).

Buxheti

- Buxheti total FP7 i Bashkëpunimit për Ushqimin, Bujqësinë, Peshkimin dhe Bioteknologjinë: 1.9 Bilion Euro
- Kontributi maksimal i KE është:
 - midis 2 dhe 6 Milion Euro për CP KBBE (deri 3 Milion Euro për CPs e vogla dhe deri 6 Milion Euro për CPs e medha)
 - deri 1 Milion Euro për CSA
 - deri 6 Milion Euro për NoE
- Intensiteti i kontributeve të BE është:
 - RTD: 50% në përgjithësi dhe 75 % për SME ose qendrat e kërkimit publik ose organizatat jo përfituese
 - Demonstrimi: 50%
 - Të tjera: 100%
 - Menaxhimi: 100%

Shkalla e suksesit e thirrjes së fundit FP7-KBBE-2008-2B

Numri i propozimeve të mbajtura: 277

Numri i propozimeve të pa mbajtura: 15

Numri i propozimeve që marrin vlerësim mbi pragun e aplikushëm: 163

Numri i projekteve të financuara: 40

Shkalla e suksesit: 14 %

Shembull i Projektit KBBE:

Titulli i plotë: Burimet e reja të ngjyruessve natyralë, shtesat e ushqimit, qëndrueshmëria gastrike dhe ushqimet e reja funksionale (COLORSPORE)

Shkurtimi: COLORSPORE

Organizata e Koordinimit

ROYAL HOLLOWAY AND BEDFORD NEW COLLEGE, UNITED KINGDOM

Thirrja: KBBE-2007-2.3-03 (Bio-) teknologjitë për prodhimin e shtesave ushqimore, ngjyruessit dhe aromë-shijet

Përshkrimi i projektit

Ushqimet funksionale sigurojnë një sektor në rritje dhe përdorimi i karotenoideve është më dinamiku jo vetëm si ngjyruess por edhe si shtesë ushqimi. Një problem i këtyre produkteve është jo qëndrueshmëria e tyre si në ruajtje dhe gjatë tretjes. Kohët e fundit, përgatitjet e karotenoidit me prejardhje bakteriale të qëndrueshme gastrike janë zbuluar nga antarët e këtij konsorsiumi dhe këto përgatitje karotenoidi të gjeneratës së dytë dhe bakteret që ato prodhojnë do të studiohen. Prototipe ekzistuese do të zhvillohen si aditivë potencialë ushqimorë por një hapësirë e zgjeruar për

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

prototipet e reja të gjeneratës së dytë, gjithashtu do të bëhen në mjediset detare.

Konsorsiumi përfshin mikrobiologë, biokimistë dhe bio-teknologë ushqimorë që do të përcaktojnë identitetin e përgatitjeve të reja të karotenoidit dhe bakteret i që prodhojnë ato.

Vlera ushqyese e këtyre baktereve do të vlerësohet dhe një vlerësim i të rrezikut i bërë duke përdorur teknologjitë moderne metabolike si dhe toksikologjinë tradicionale, me qëllim projektimin e prototipeve si QPS (masat e kualifikuara të sigurisë)

Bio-përpunimi i këtyre preparateve bakteriale të karotenoidit do të eliminojë sintezën kimike tradicionale dhe përdorimin e solventëve organikë.

Gjithashtu sistemi i dërgimit do të përdorë një matricë sinergjike biologjike duke e bërë atë një burim të qëndrueshëm.

Karakteristika të tjera:

Referenca e projektit: 207948

Data e fillimit: 2008-06-01

Zgjatja: 36 muaj

Kostoja e projektit: 4.1 milion euro

Data e përfundimit: 2011-05-31

Fondet e projektit: 3 MEuro

Pjesëmarrësit

1.3.2 Kërkimi për SME te

Table the same as page 7

Objektivat

- Të mbështeten grupet e vogla të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme innovative në zgjidhjen e problemeve teknologjike dhe arritjen e njohurive teknologjike.
- Të lejojë grupet e SME të nënkontraktojnë aktivitete RTD në qendrat e kërkimit
- Të lehtësojë bashkëpunimin kombëtar midis SME-ve dhe qendrave të kërkimit.

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

Arritja

Pjesëmarrësit e SME-ve janë përfituesit e drejtpërdrejtë të projektit: ata investojnë në projektin RTD dhe paraqesin shumicën e aktiviteteve kërkuese dhe demonstruese tek RTD. SME-të në kthim marrin njohuritë teknologjike që ato kanë nevojë të zhvillojnë, ose përmirësojnë produktet ekzistuese, sistemet, proceset ose shërbimet.

Pjesëmarrësit

- 3 SME nga 2 EU ose vende të asociuara
- 2 qendra kërkimi të pavarura, nga 2 EU ose vende të asociuara
- Madhësia: 6 deri 10 partnerë

SME-të menaxhojnë projektin

- Koordinimi mbështetet nga një SME
- Kostot e koordinimit janë të pranueshme
- Qendrat e kërkimit janë nënkontraktorë
- Të drejtat e pasurisë intelektuale i përkasin SME-ve

Tipet e aktiviteteve të financuara

- RTD
- Demonstrim
- Trainim
- Menaxhim
 - Administrim
 - Teknik

Kohë zgjatja

12 deri 24 muaj

Aftësitë intelektuale

- Pa ndonjë marrëveshje të veçantë SME janë pronarët e rezultateve
- SME-të mund të shesin një pjesë të rezultateve tek qendrat Kërkimore
- Në marrëveshje mbi aftësitë Intelektuale duhet përfshihet në propozim

Kriteri i vlerësimit

- Ekselencë shkencore dhe teknike
- Cilësi dhe efektivitet menaxhimi
- Impakt

Buxheti

- Buxheti total i Kërkimit të Kapaciteteve FP7 për përfitim të SME-ve; 1.3 Bilion Euro
- Për produktet e reja, shërbimet ose përpunimet, buxhetet janë midis 0.5 dhe 1.5 milion Euro
- Intensiteti i kontributeve të KE për diapazonet e tipit të aktivitetit nga 50%,75% në 100%, në varësi të aktiviteteve
 - Kërkimi i kryer nga RTD duhet të mbulojë 60% të aktiviteteve totale
- Kërkimi mund të realizohet nga qendrat e kërkimit publike ose private, SME-të me teknologji të lartë ose grupe industriale

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

Shënim: Kontributet e Komisionit European nuk mund të kalojnë 110% të shumës së paraqitur nga RTD për aktivitetet RTD dhe demonstrative.

Shkalla e suksesit e thirrjes së fundit 2008-1

Numri i propozimeve të mbajtura: 673

Numri i propozimeve të pazgjedhura: 10

Numri i propozimeve që marrin një vlerësim mbi pragun e aplikuar: 267

Numri i projekteve të financuara: 92

Shkalla e suksesit:13.6%

Shembull

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

Titulli i plotë: Reduktimi i pesticideve në kultivimin e kërpudhës në Evropë

Acronym: PRIME

Organizimi i koordinimit: BIOLOGICAL CROP PROTECTION LTD, UNITED KINGDOM

FP5 Shkurtim i Programit; CILËSIA E JETËS

FUQI

Përshkrimi i projektit

Objektivi kryesor i projektit është të zhvillojë një strategji të kontrollit të dëmtuesve për industrinë e prodhimit të kërpudhës, e cila është më pak e lidhur me inputet e pesticideve kimike. Ky koncept jo vetëm do të përmirësojë konkurrencën e industrisë në lidhje me uljen e kostos së produktit por do të rritë besimin e konsumatorit në lidhje me mbetjet kimike apo ndotjen e insekteve në produkt. Reduktimi i pesticideve kimike gjithashtu do të përmirësojë kushtet e shëndetit dhe të sigurisë për punonjësit e lidhur me industrinë e prodhimit të kërpudhës në Evropë.

Industria e prodhimit të kërpudhës në Evropë që përfshin prodhuesit e plehut, prodhuesit e ambalazheve, rritësit ka nevojë vendesh për 50 000 punonjës.

Prodhimi vjetor total i kërpudhës në BE është 900 000 ton me një vlerë 3 000 milion euro në vit. Kontrolli i dëmtimit nga insektet në prodhimin tregtar të kërpudhës në Evropë është një problem në rritje dhe duke patur parasysh 60 milion euro të shpenzuara për masat e kontrollit të dëmtuesve, humbjet e prodhuara për shkak të sulmit të dëmtuesve llogariten dhe 123 milion euro të tjera. Heqja e insekticidëve, intolerance e bimës dhe zhvillimi i rezistencës së dëmtuesve, kontriboi në besueshmërinë e përbërësve të insekticideve për të kontrolluar secilën nga speciet dëmtuese kryesore.

Kërkimi i propozuar do të sigurojë një strategji të kontrollit të dëmtuesve të qëndrueshme, ekologjisht të shëndoshë dhe tregëtisht të konkurrueshme për industrinë e prodhimit evropian të kërpudhës.

Karakteristika të tjera:

- Referenca: QLK5-CT-2002-70693
- Data e fillimit: 2002-10-01
- Zgjatja: 32 muaj
- Tipi i kontratës: kontrata kërkimi bashkëpunues
- Kostoja projektit: 455k
- Data e përfundimit: 2005-05-31
- Statusi projektit: Kompletuar

Pjesëmarrësit

Konsorsiumi përbëhet nga shtatë partnerë, duke përfshirë katër ndërmarrje tregtare të vogla deri mesatare dhe tre institute kërkimi brenda Evropës, që përfshinë Belgjikën, UK dhe Republikën e Irlandës

1.3.3. Potenciali kërkimit (RegPot)

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

Objektivat

Nxitja e potencialit kërkues në BE e zgjeruar duke shpalosur dhe zhvilluar potencialin kërkues në krahinat e konvergencës dhe ato më të largëta të BE dhe ndihma për të forcuar kapacitetet e kërkuesve të tyre që të marrin pjesë me sukses në aktivitetet kërkuese në nivelin e BE.

Arritja

Çdo qendër kërkimi nga BE ose nga vendet e asociuara mund të aplikojnë për fonde për të modernizuar qendrën e saj, të rritë ekselencën e saj dhe të integrojë më mirë Zonën Evropiane të Kërkimit.

Pjesëmarrësit

- 1 zonë kërkimi që të punojë për çdo temë kërkimi të FP7
- Fokusim në qendrat e kërkimit nga krahinat e konvergencës dhe ato më të largëta të BE1

Universitetet ose qendrat e kërkimit në BE do të zgjidhen që të bashkëpunojnë me qendrën e kërkimit në mynyrë përfituese, me qëllim shkëmbimin e njohurive dhe praktikave më të mira që duhen bërë.

Tipet e aktiviteteve të financuara

- Trainim
- Menaxhim
 - Administrativ
 - Teknik

Shënim: aktivitetet kërkuese nuk zgjidhen në një projekt RegPot dhe nuk do të përfshihen. Çdo shpenzim i lidhur me kërkimin (të konsumueshme, koha e harxhuar nga kërkuesit në projektet RTD) nuk do të financohen.

Aktivite të detajuara

1 Në shtator 2008: vendet që vijojnë janë zgjedhur për RegPot: Shqipëria, Kroacia FYROM, Montenegro dhe Serbia, Hercegovina dhe Kosovo do të zgjidhen kur të fimoset marrëveshja e asociimit me BE.

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

- Zgjedhje trans-kombëtare në dy rrugë të stafit të kërkimit në krahinat e konvergjencës
- Blerje dhe zhvillim i pajisjeve të kërkimit
- Organizim workshopesh dhe konferencash për të lehtësuar transferimin e njohurive
- Vlerësim ndërkombëtar i pavarur i ekspertëve të cilësisë së kërkimit dhe infrastrukturave brenda aplikimeve të qendrës së Kërkimit

Kohë zgjatja

Rreth 36 muaj

Skema e fondeve

Veprime koordinuese dhe mbështetëse

Cilësitë intelektuale

Jo e zbatueshme meqënëse nuk ka punë RTD

Kriteri i vlerësimit

- Ekselencë shkencore dhe teknike
- Cilësi dhe efektivitet menaxhimi
- Impakt

Buxheti

- Buxheti total i kapaciteteve FP7 të potencialit kërkues: 340 milion Euro
- Buxhetet janë rreth 1 Milion Euro
- Kontributi i BE është 100%

Shkalla e suksesit e thirrjes së fundit 2008-1

Numri i propozimeve të mbajtura: 475

Numri i propozimeve të pa zgjedhura: 24

Numri i propozimeve që kanë një vlerësim mbi pragun e aplikueshëm: 193

Numri i projekteve të financuara: 32

Shkalla e suksesit: 6.7%

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

Shembull

Titulli i plotë: Hapja e potencialit kerkues të cilësisë së ushqimit të kafshëve në krahinë e Baltikut duke zhvilluar kapacitetet shkencore dhe teknike të institutit të kërkimit Sagra

Shkurtimi: BALTFoodQUAL

Organizata koordinuese

LATVIJAS LAUKSAIMNIECIBAS UNIVERSITATE LATVIA

Thirra: REGPOT-2007-1-01

Përshkrimi projektit

Qëllimi i projektit është të zhvillojë potencialin S&T të qendrës së kërkimit të premtuar të Latvias – Instituti i Kërkimit Sagra, me qëllim forcimin e kërkimit në nivel të lartë mbi ushqimin e kafshëve dhe cilësinë e ushqimit, në bashkëpunim me skuadrat kërkuese nga vëndet e tjera të BE, si dhe të kontribuojë në zhvillimin e kapacitetit kerkues të zonës së Baltikut dhe integrimin e saj në Zonën Evropiane të Kërkimit.

- Objektivi afatgjatë:

Të stimulojë realizimin e potencialit të plotë të kërkimit të BE së zgjeruar duke hapur dhe zhvilluar potencialin ekzistues të kërkimit në një nga zonat e konvergencës të Baltikut.

- Objektivat afatshkurtër:

1. Të forcojë kapacitetin e kerkuesve të Institutit të Kërkimit Sagra, që të marrë pjesë në nivel BE në projektet kërkuese dhe aktivitetet mbi ushqimin e kafshëve dhe cilësinë e ushqimit
2. Të përmirësojë kapacitetin teknik të Institutit të Kërkimit Sagra për të kryer kërkime me cilësi të lartë mbi ushqimin e kafshëve dhe impaktin e tyre mbi shëndetin e konsumatorëve.

Karakteristika të tjera:

- Referenca: 205079
- Dita e fillimit: 2008-02-01
- Zgjatja e programit: 36 muaj
- Kostoja e projektit: 1.1Milion Euro
- Tipi i kontratës: Veprime të mbështetura
- Data e përfundimit: 2011-01-31

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

1.3.4 Veprimet Mari Kyri (Njerëzit)

Objektivat

Ky program i veçantë siguron trainim kërkimi, zhvillim karriere dhe skema mobiliteti që i lejojnë kërkuesit të jenë më të lëvizshëm edhe ndërkombëtarisht dhe midis sektorëve tregtarë dhe jo tregtarë. Ka mundësi për kërkuesit në çdo stad karriere dhe të çdo kombësie.

Pesë drejtimet kryesore dhe buxheti

Dedikuar plotësisht burimeve njerëzore në kërkim, ky nën program ka një buxhet të përgjithshëm deri 4.7 bilion, euro gjatë shtatë viteve të FP7. Ai do të implementohet përmes veprimeve “Mari Kyri” nën katër tituj, me ndarjen e buxhetit si vijon:

HandBook “How to turn your ideas into European Projects?”

EU-BALKAN-FABNet Page 19 of 53

Pjesëmarrësit

Veprimet nën Programin e veçantë “Njerëz” i adresojnë kërkuesit e të gjithë stadeve të karrieraës, në sektorët publikë dhe privatë. Kërkuesit janë të paktën në nivel post graduate ose ekuivalent dhe janë klasifikuar mbi bazën e eksperiencës profesionale.

Objektivat

Rrjetet trainuese fillestare Mari Kyri synojnë në përmirësimin e perspektivës së karrierës së kërkuesve, të cilët janë në pesë vitet e para të saj, duke iu ofruar trainime të strukturuar në hapësira shkencore dhe teknologjike të përcaktuara mirë si dhe sigurojnë aftësi shtesë dhe ekspozim të kërkuesve në sektorët e tjerë, duke përfshirë kompanitë private

Veprimet

- **Bursë Evropiane - Intra (IEF)**

Ky veprim mbështet zhvillimin e karrierës së kërkuesve me eksperiencë në stade të ndryshme të karrierës së tyre dhe kërkon të rritë kompetencën e tyre individuale, diversifikim në kuptimin e fitimit të aftësive në nivel shumë ose ndër-disiplinor dhe duke ndërmarrë eksperiencë ndër-sektoriale. Qëllimi është mbështetja e kërkuesveit në arritjen dhe forcimin e një pozite të pavarur drejtuese p.sh. vëzhgues kryesor, profesor ose pozicione të tjera më të larta në edukim ose ndërmarrje. Veprimi asiston kërkuesit të bëjnë karrierë në kërkim edhe pas një shkëputjeje.

- **Grantet Evropiane Ri-integruese**

Ky veprim synon të asistojë kërkuesit me eksperiencë në ri-integrimin në një karrierë kërkimi pas një experience lëvizjeje trans-kombëtar brenda Veprimeve “Mari Kyri”. Veprimi inkurajon kërkuesit të ndërtojnë në periudhën e lëvizjes së tyre transkombëtare në kuadrin e një projekti profesional koherent dhe të promovojnë perspektivat e zhvillimit të karrierës së tyre kërkuese

- **Bashkë financimi i Progresit Krahinor Kombëtar & Ndërkombëtar (COFUND)**

Ky veprim synon rritjen e mundësisë së lëvizjes së gjerë Evropiane, për trainimin dhe zhvillimin e karrierës së kërkuesve me eksperiencë, në përputhje me objektivat e vendosura në titullin e aktivitetit “Trainimi i gjatë dhe zhvillimi i karrierës”, kështu duke rritur impaktin e tij të përgjithshëm. Bashkëfinancimi synon programe që mbështesin lëvizjen trans kombëtare të kërkuesve me eksperiencë në stade të ndryshme të karrierës së tyre, duke përfshirë kërkues, menjëherë pasi kanë marrë një doktoratë, duke zgjeruar ose thelluar kompetencën e tyre individuale në veçanti në kuptimin e marrjes së aftësive shumë ose ndër disiplinare ose duke patur eksperiencë ndërsektoriale, për të mbështetur kërkuesit në arritjen dhe forcimin e një vendi të pavarur drejtues p.sh. investigues kryesor, profesor ose pozicion tjetër senior në edukim ose ndërmarrje: Të ri-integrojnë kërkuesit në një karrierë kërkimi në Shtetet Antare dhe vendet e asociuara, duke përfshirë vendin e tyre të origjinës, pas një ekperience në kuadrin e një mobiliteti.

Partneriteti Industri Akademi dhe Lidhjet (IAAP)

Ky veprim kërkon të hapë dhe të vendosë lidhje dinamike midis organizatave publike të kërkimit dhe ndërmarrjeve tregtare private, në veçanti SME-ve duke përfshirë industrinë tradicionale manufakturoese, të bazuara në programe kooperimi për kohë të gjatë, me potencial të lartë për të rritur ndarjen e njohurive dhe kuptimin e dyanshëm të çështjeve të ndryshme kulturele dhe kërkesat e aftësive të sektorëve industrialë dhe akademikë.

Bursa ndërkombëtare (IFO)

Ky veprim synon të forcojë dimensionin ndërkombëtar të karrierës së kërkuesve Evropianë duke i dhënë atyre rastin të trainohen dhe të marrin njohuri të reja në një vend të tretë, me organizim kërkimi me nivel të lartë. Më tej, këta kërkues do të kthehen me njohuritë e marra dhe eksperiencën tek një organizatë në një Shtet antar ose vend i Asociuar.

Granti ndërkombëtar i ri-integrimit (IRG)

Objektivi i këtij veprimi është forcimi i tërheqjes së Evropës duke inkurajuar kërkuesit Evropianë, që kanë kryer kërkime jashtë Evrope për të paktën 3-vjet, të ri-integrohen në një shtet antar ose në një vend të asociuar, me qëllim që të kontribuojnë në kërkimin Evropian dhe të transferojnë njohuritë që ata kanë marrë në një vend të tretë, duke iu ofruar atyre mundësinë të përfundojnë në Evropë eksperiencën e tyre. Synohet në llogaritjen e rrjedhjes së trurit Evropian në vendet e treta. Ajo do të lejojë gjithashtu zhvillimin e bashkëpunimit të gjatë me mjedisin shkencor dhe industrial të vendit të tretë nga i cili ata janë kthyer.

Shkëmbimet ndërkombëtare të stafit (IRSES)

Skema e shkëmbimit ndërkombëtar të stafit Mari Kyri është një modalitet i ri implementimi, që synon në forcimin e partneritetit të kërkimit përmes shkëmbimeve të stafit dhe aktiviteteve të rrjetit midis organizatave të kërkimit Evropian dhe organizatave nga vendet me të cilat Komuniteti ka një marrëveshje S&T ose janë në proces për të negociuar një të tillë dhe vendeve fqinje me ato Evropiane. E krahasuar me aksionet eksistuese Mari Kyri, të cilat sigurojnë mundësi mobiliteti tek kërkuesit individualë, ky aksion i ri do të sigurojë mbështetje organizatave kërkuese të vendosin apo të forcojnë bashkëpunimin e kërkimit afatgjatë përmes një programi të koordinuar të shkëmbimit të kërkuesve për periudhë të shkurtër.

Orientimet e së ardhmes

Në parim, viti 2009 do të jetë një vazhdim i Veprimeve kryesore Mari Kyri të vitit 2008. Në këtë stad nuk janë parashikuar Veprime Mari Kyri. Veprimet Mari Kyri janë në fakt dy veprimet e reja të implementuara për herë të parë në 2008, COFUND dhe IRSES; ato duhet të monitorohen mirë, që të identifikohet nevoja e mundshme për pershtatje. Për më tepër, në kontekstin e letres jeshile, të lëshuar së fundi në Zonën Evropiane të kërkimit, Komisioni ka nxjerrë një këshillim publik, i cili do të japë përfundimet në fund të vitit. Kjo rrit

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

Iniciativat ose ndryshon në theksimin ose modifikimin e inicativave ekzistuese të programit “NJEREZ”.

Shembull

Titulli i plotë: Metabolomics: Përcaktimi i standardeve për përgatitjen e mostrës së molekulave të vogla
(METABOLOMICSSTANDARD)

Organizata koordinuese

QIAGEN GMBH, GERMANY

Thirrja: NJERËZ-2007-3-1-IAPP Veprimi Mari Kyri

Përshkrimi i projektit

Qëllimi i përgjithshëm i metabolomics është të identifikojë masën dhe të interpretojë përqëndrimin kompleks të lidhur me kohën, fluksin dhe aktivitetin e metabolitëve, në një mostër biologjike.

Metabolitët përfshijnë molekula të vogla që janë produktet dhe ndërmjetësit e metabolizmit, por gjithashtu karbohidratet, peptidet dhe lipidet dhe mund të shikohen si karakterizim kimik i fenotipeve. Si më i riu i fushës së omics, metabolomics janë akoma në zhvillim. Kërkimi në vazhdim fokusohet në zhvillimin e genomikëve të rinj dhe veglave proteomikë dhe përdorimi i këtyre afrimeve për studimin e funksionit qelizor. Në kontrast, pak programe kërkimi fokusohen mbi metabolomics. Një prej problemeve më të rëndësishëm që është identifikuar nga kërkuesit në kërkimin e metabolomics, është mungesa e standardizimit të hapit të përgatitjes së mostrës.

Karakteristika të tjera:

- Referenca: 217895
- Data e fillimit: 2008-08-01
- Zgjatja: 48 muaj
- Kosto e projektit: 430 690 euro
- Tipi i kontratës: Partnershipi Industri-Akademi dhe Rrugët (IAPP)
- Data e përfundimit: 2012-07-31

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

1.3.5 Agjencia e Kërkimit Evropian (Idetë e veçanta të programit)

Objektivat

Programi i veçantë “Ide” siguron fonde konkurruese për ‘kërkim bazë’ të kryer nga ekipet individuale. Komunikimi dhe përhapja e rezultateve të kërkimit është një aspekt i rëndësishëm i këtij programi.

Mjetet

Një këshill Kërkimi Evropian (ERC), që përbëhet nga një Këshill Shkencor i pavarur dhe një strukturë implementimi, është vendosur për këtë program të veçantë.

ERC mbështet projektet e drejtuara nga investigusi në ‘kërkim bazë’, të kryera nga ekipet individuale, që konkurrojnë në nivel Evropian, brenda dhe përmes gjithë fushave të kërkimit. Buxheti i tij i përgjithshëm brenda FP7 është 7.5 bilion Euro për 7 vjet (2007-2013)

Kërkesë

Po të jesh ‘investigator driven’ ose ‘bottom up’, kërkesa e ERC lejon kërkuesit të identifikojnë rastet e reja dhe udhëzimet për kërkim, megjithëse drejtohen nga prioritetet të vendosura nga të tjerët. Kjo kërkesë siguron që fondet janë kanalizuar në zona kërkimi të reja dhe premtuese me një shkallë më të madhe fleksibiliteti.

Pjesëmarrësit dhe vlerësimi

Grantet ERC caktohen përmes garës së hapur për projekte të drejtuara nga kërkues të rinj dhe të stabilizuar, pavarësisht nga origjina e tyre, që punojnë në Europë - kriteri i vetëm për zgjedhje është ekselencia. Qëllimi është që të njihen idetë më të mira, të ruhet dhe të paraqitet statusi dhe vizibiliteti i trurit më të mirë në Evropë, duke tërhequr ndërkohë dhe talentet nga jashtë.

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

Ka tre tipe kryesore të skemave grant: Granti fillestar ERC, granti i përparuar ERC dhe Veprimi i Koordinuar dhe Mbështetës. Vetëm dy skemat e para jepen këtu (CSA synon të ndihmojë funksionimin e ERC përmes monitorimit ose vlerësimit.)

Granti fillestar ERC

- Intensiteti i kontributeve të BE është 100%,
- Zgjatja: rreth 5 vjet,
- Profili: Një investigues kryesor i Grantit fillestar kompetitiv duhet të ketë treguar potencialin për pavarësi kërkimi dhe performancë pjekurie.
- Aplikantët duhet gjithashtu të jenë në gjendje të demonstrojnë një regjistrim premtues të arritjeve të hershme, në përputhje me fushën e kërkimit dhe stadin e karrierës duke përfshirë publikime domethënëse (si autor kryesor) në revistat shkencore shumë-disiplinore ndërkombëtare kryesore. Ato gjithashtu mund të demonstrojnë një regjistrim të punëve të dhëna në konferenca ndërkombëtare, grantet patenta, çmime etj.
- Një vlerësim i kontrolluar: Një dokument i propozimit të plotë do të vlerësohet në dy faza. Vlerësimi do të drejtohet nga mjetet e një strukture dhe paneleve të një niveli të lartë të kontrolluar. Ekselenca është i vetmi kriter vlerësimi.
- Ndarja e buxhetit:
- Shkenca fizike & inxhinierike: 39%
- Shkencat e jetës: 34%
- Shkenca shoqërore & humanitare: 14%
- Ndërdisciplinare: 13%

Granti i përparuar ERC

Qëllimi është të financohen ekipet e drejtuara nga Investiguesit kryesorë të stabilizuar, inovativë dhe aktivë, pavarësisht nga kombësia, mosha ose vendi. Ato do të përfshijnë p.sh: kontribuesit, udhëheqës të përparuar në kërkime në Evropë, shkencëtarët udhëheqës të “diasporas” Evropiane ose ato me kombësi jo evropiane, të cilët dëshirojnë të vendosin veten në Evropë dhe ndjekin kërkim “Ground-breaking”, me rrezik të lartë, por që hap drejtime të reja në fushat e kërkimit respektive.

- Kontributi i BE: 100%
- Zgjatja: rreth 5 vjet
- Profili: Aplikantët për Grantin e përparuar ERC pritet të jenë kërkues aktivë dhe të kenë një rekord kërkimi domethënës në 10 vitet e fundit, që duhet paraqitur në kërkesë. Ka pak mundësi për sukses kur kjo kërkesë rekordi mungon, sepse ai identifikon investiguesit si drejtues të veçantë në kuptimin e origjinalitetit dhe domethënies së kontributeve të tyre të kërkimit.
- E njëjta ndarje buxheti si më sipër

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

Buxheti

- Buxheti total i FP7: ide kapacitete: 7.5 bilion Euro
- Buxhetet janë rreth 1MEuro për një grant fillestar

Shkalla e suksesit për 2007 për grant fillestar ERC

Numri i propozimeve të mbajtura, hapi një: 8 794

Numri i propozimeve të mbajtura, hapi dy: 559 (shkalla e suksesit 6%)

Numri i projekteve të financuara: 300 (shkalla suksesit 54%)

Shkalla suksesit: 3.4 %

Më shumë informacion: ftp://ftp.cordis.europa.eu/pub/fp7/docs/erc-annual-report_en.pdf

Shembull:

Titulli i plotë: Analiza e integruar evoluese e sistemeve ndërvepruese gjenetike dhe transformuese në majatë.

(EVOLUIMI I RRJETIT)

Organizata koordinuese

MAGYAR TUDOMANYOS AKADEMIA SZEGEDI BIOLOGIAI KOZPONTJA, HUNGARY

Thirrja: ERC-StG Grante fillestare

Përshkrimi i projektit

Aftësia e sistemeve qelizorë për tu përshtatur ndaj ndërhyrjeve gjenetike dhe mjedisit është një proces themelor por i kuptuar dobët si në nivelin molekular dhe atë evolues. Ekzistojnë arsye fiziologjike dhe evoluese pse lidhjet shpesh kanë impakt të kufizuar në rritjen qelizore. Së pari, ndërhyrjet që godasin një target, nuk kanë efekt mbi performancën e plotë të një sistemi kompleks (të tillë si sistemet metabolike) por ndërhyrjet mund të rregullohen duke riorganizuar flukset në sistemet metabolikë, ose duke ndryshuar rregullin dhe shprehjen e geneve. Së dyti, për shkak të zhvillimit të shpejtë të mikrobeve, efekti i një ndërhyrjeje mund të shmanget me evolimin e mutacioneve kompensuese në vendet e tjera të rrjetit. Të kuptuarit e shtrirjes të fortësisë së jashtme dhe të evolucionit në sistemet qelizore kërkon analiza të integruara, që kombinojnë genomikë funksionale dhe biologjinë e sistemeve kompjuterikë me eksperimente mikrobialë evolutivë.

Karakteristika të tjera:

- Referenca: 202591
- Data e fillimit: 2008-07-01
- Kohëzgjatja: 60 muaj
- Kostoja projektit: 1.28MEuro
- Tipi i kontratës: Grant fillestar ERC
- Data e përfundimit: 2013-06-30
- Statusi i projektit: Ekzekutim

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

Kapitulli II: Si ai funksionon?

Ky kapitull paraqet një pamje të përgjithshme të FP7; mekanizmin, burimet e informacionit dhe hapat kryesore të një thirrjeje, pjesëmarrësit potencialë dhe shkallën financuese.

2.1 Cilat janë parimet e përgjithshme?

Ka gjashtë stadi të rëndësishme në jetën e projektit, të cilët do të paraqiten në këtë kapitull. Këto janë si vijon:

- Thirrja e re për propozimet është hapur
- Përgatitja e propozimit
- Vlerësimi i propozimit nga ekspertët e pavarur
- Negocim me BE
- Implementimi i prokektit
- Raportimi

2.1.1 Komisioni Evropian lëshon thirrjet për propozimet

Komisioni Evropian ka detyrë të përcaktojë dhe botojë programet e punës vjetore dhe thirrjet për propozime. Ata adresojnë ose çeshtje shkencore të veçanta ose çeshtje teknologjike ose ofrojnë zgjedhjen e çështjes së kërkimit tek pjesëmarrësi (veçanërisht për disa thirrje të dedikuara SME-ve)

Thirrja për propozimet dhe programin e punës përcakton:

- Temën që do mbulohet
- Tipin e instrumentit (CP, CSA etj)
- Buxhetin
- Kohën e përfundimit për propozimin
-

Thirrja për propozime dhe programi i punës shoqërohen me udhëzime të detajuara për përgatitjen e propozimit.

Draft-Versionet dhe programi i punës nganjëherë qarkullojnë midis kërkuesve përpara se të botohet versioni përfundimtar.

Thirrjet për propozime dhe programi i punës gjithmonë botohen tek Cordis
website: <http://cordis.europa.eu/fp7> section “find a call”.

Një shembull i thirrjes për Ushqimin, Bujqësinë, Peshkimin dhe Bioteknologjinë botuar në 2007 me afat skadimi në Shkurt 2008 (KBBE-2008-2B), paraqitet në faqen që vijon:

Plani i përgjithshëm i punës së programit:

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

2.1.2 Aplikantët përgatitin propozimet

Para fillimit të projektit është e rëndësishme të verifikohet nëse ai i përgjigjet një numri të caktuar kërkesash.

- Pse projekti juaj është vendimtar (çfarë vështirësie zgjidh ai)?
- Ka ai një vlerë të shtuat evropiane?
- Cilat janë përfitimet e projektit? Çfarë përmirëson ai?
- Është ai inovativ ose lejon progres të mëtejshëm?
- Cilat janë përparësitë e projektit tuaj? Çfarë e bën atë konkurrues?

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

Është e rëndësishme të lexohen me kujdes dokumentat e përshtatshme dhe veçanërisht këto që vijojnë: programi punës, udhëzimi vlerësues dhe drejtimet financiare.

Propozimi duhet të ketë kërkesat nga fillimi.

Ai paraqet:

- Objektivat e projektit
- Progresin përtej gjendjes në zonën e përfshirë
- Organizimin e projektit
- Detyrat e ndryshme që do të kryhen
- Planin dhe buxhetin e projektit
- Profilin e pjesëmarrësve
- Impaktet e pritura të projektit (në lidhje me tregun dhe vlerën e shtuar)

Propozimi duhet në mënyrë strikte të ndjekë një model të dhënë. Formatu është spjeguar në udhëzimin për aplikantët dhe është botuar me thirrjen. Propozimi duhet transmetuar on-line duke përdorur Sistemin transmetues të propozimit elektronik (EPSS) përpara afatit të skadimit të specifikuar në thirrje.

Kini kujdes:

- Vlerësoni më përpara afatin e përfundimit, mbani mend se partnerët tuaj rallë do të përgjigjen aq shpejt sa nevojitet.
- Për më tepër, kur i afroheni më pranë datës përfundimtare, problemet teknike mund të rrezikojnë vazhdimin e projektit. Gjithnjë mbani një version të parë të propozimit tuaj të EPSS, përpara ditës së fundit.

2.1.3 Propozimet janë vlerësuar

FP7 bazohet mbi thirrjet kompetitive për propozimet, pra për çdo temë të një thirrjeje të dhënë, disa konsorsiume përgatitin propozimet dhe vetëm më të mirët do të financohen.

Për të përcaktuar cilat propozime do të financohen, një panel ekspertësh të pavarur (jashtë BE) krijohet nga Komisioni Evropian. Vlerësimi bazohet mbi kriteret që vijojnë:

- Cilësi shkencore dhe teknike
- Cilësi dhe efikasiteti i implementimit të menaxhimit
- IMPAKT (Impakt potencial përmes zhvillimit, shpërndarjes dhe përdorimit të rezultateve të projektit).

Maksimumi që merret është në total 15 pikë, 5 pikë për çdo kriter. Për të marrë financim, projekti duhet të marrë të paktën tre pikë për secilin nga kriteret dhe rezultati total duhet të jetë të paktën 10 pikë. Zakonisht niveli i konkurrencës është kaq i lartë sa një propozim me rezultat total nën 13 ka shumë pak shanse të ketë sukses.

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

2.1.4 Negocimi

Sapo projekti pranohet (faza e vlerësimit kërkon 3 muaj) konsorsiumi dhe Komisioni negociojnë marrëveshjen grant, që përcakton detyrat që do të kryhen, buxhetin dhe kontributin, që do të merret nga Komisioni Evropian.

2.1.5 Implementimi i projektit

Projekti implementohet pas firmosjes të marrëveshjes grant. Partnerët marrin pagesa në avancë por pagesa finale bëhet pas përfundimit të projektit.

2.1.6 Raportimi

Gjatë projektit, puna e bërë dhe shpenzimet e lidhura me të, duhet të raportohen me saktësi në Komisionin Evropian. Burimet financiare të paraqitura në një projekt të veçantë, janë vetëm përfundimtare dhe të sigurta kur të gjitha shpenzimet janë bërë, provuar dhe miratuar nga Komisioni Evropian. Në qoftë se shpenzimet nuk janë në përputhje me buxhetin ose nuk plotësojnë rregullat financiare FP7, Komisioni Evropian kërkon rimbursim të pagesës së parë.

Raportet do të konsistojnë në një dokument financiar të rregullt të kostos si vijon:

- Shpenzime përmes faturash
- Kosto të personelit me fatura kohe, të cilat duhen mbushur dhe firmosur nga çdo punonjës i projektit:

Forma C është forma që çdo përfitues i projektit FP7 duhet të mbushë dhe plotësojë në Komisionin Evropian sipas periudhave raportuese, të përcaktuara në Marrëveshjen Grant.

2.2 Cfarë lloj projektsh?

Sipas FP7 mund të financohen lloje të ndryshme projektsh.

Skemat financuese që vijnë, kanë interes të veçantë për qendrat e kërkimit:

- Projektet bashkëpunuese synojnë të zhvillojnë teknologjitë e reja në një zonë shkencore të veçantë dhe të mbledhin kompanitë, qendrat e kërkimit ose trupat publikë nga gjithë Evropa në një konsorsium që do të punojë së bashku për një kohë midis 18 dhe 48 muaj.
- Sistemet e ekselencës janë bashkëpunimi midis qendrave të kërkimit të specializuara në një fushë të dhënë. Ato synojnë integrimin dhe ndarjen e njohurive shkencore në nivel Evropian, duke kontribuar kështu në krijimin e Zonës Evropiane të Kërkimit.
- Veprimet e koordinimit dhe mbështetjes për projektet që nuk përfshijnë aktivitetet kërkuese. Një shembull është projekti FABNET në Ballkan i BE, i cili synon trainimin e kërkuesve nga Vendet e Ballkanit Perëndimor mbi FP7. Veprimi koordinues dhe mbështetës është gjithashtu instrumenti i përdorur në nënprogramin Potencial të Kërkimit. (REG POT)
- Këto projekte synojnë të stimulojnë kapacitetin e kërkimit duke siguruar mbështetje vetëm për një organizatë kërkimi (duke përfshirë organizatat kërkuese nga Vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo është bërë kryesisht përmes mbështetjes për sisteme, shkëmbim stafi dhe blerje pajisjesh për çdo temë kërkimi të mbuluar nga FP7. Një thirrje e re për propozimet do të hapet në 2009.

2Në shtator 2008: Vendet që vijnë janë zgjedhur në RegPot: Shqipëria, Kroacia, FYROM, Mali i Zi dhe Sërbia. Bosnja-Hercegovina dhe Kosova do të zgjidhen kur marrëveshja e asociimit me BE të firmoset, shih http://cordis.europa.eu/fp7/who_en.html#countries for updates.

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

- **Projektet e kërkimit për përfitimet e SME-ve** mbledhin SME të ose shoqatat e SME-ve dhe aktorët RTD në një ide innovative të veçantë. Partnerët RTD punojnë si nënkontraktorë për SME që financojnë gjithë përpjekjen kërkuese. Në fund të projektit SME të mbajnë të drejtat intelektuale të cilësisë dhe pronësinë e inovacioneve të sjella nga përpjekja kërkimit.

2.3 Cili mund të marrë pjesë?

FP7 është e hapur në një diapazon të gjërë organizatash, kompanish, SME, qendra kërkimi, kërkuesish individualë (për grantet Mari Kyri), universitete, organizata jo qeveritare

FP7 është e hapur për çdo organizatë nga Shtetet Antare të BE dhe Vendet e Asociuara në FP7. Ai është gjithashtu i hapur për një numër të madh vendesh të treta, të cilat konsiderohen si Vende partnere për kooperimin nderkombëtar.

Organizatat nga këto vende marrin pjesë në FP7 nën kushte minimale.

Në Vendet e Ballkanit Perëndimor – Shqipëria, Kroacia, ish rep. Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbia dhe Bosnja Hercegovina (nga 2009) janë Vende të Asociuara.

2.4 Çfarë është financiar?

Në projektet FP7, aktivitete të ndryshme janë financuar për ar sye pune të pastër kërkimi. Financimi i aplikuar tek aktivitetet që vijojnë:

- Kërkim dhe zhvillim teknologjik (RTD)
- Menaxhim
- Demonstrim
- Të tjera (trainim, shpërndarje)

Komisioni Evropian financon shpenzimet e lidhura me kostot e personelit (kosto e punës e bazuar për një muaj dhe koha e harxhuar nga punonjësit e organizatës), pajisja (duke marrë parasysh zhvleftësimin e pajisjes dhe përdorimin e saj në projekt), të konsumueshmet, shpenzimet e udhëtimit dhe koston e lidhur me organizimin e ngjarjeve.

2.5 Si të gjejmë rastet?

Programi i punës dhe thirrjet për propozimet gjenden në adresën e internetit të **Komunitetit dhe Shërbimin e Informacionit (CORDIS):**

<http://www.cordis.europa.eu/fp7>

HandBook “How to turn your ideas into European Projects?”

Duke klikuar në “gjej një thirrje” ju do të gjeni gjithë thirrjet për propozimet që janë të hapura për pjesëmarrje dhe skadimin e kohës për çdo program specifik

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

Ju do të gjeni gjithë dokumentat (programin e punës së thirrjes, udhëzimet për aplikantët të cilët do ju ndihmojnë ju të shkruani propozimin) të asociuar me një thirrje specifike duke klikuar emrin e kësaj thirrjeje.

Pikat Kombëtare të Kontaktit (NCP) janë struktura kombëtare të financuara nga qeveritë e Shteteve antare të BE dhe Vendet e Asociuara që marrin pjesë në Program. NCP jep mbështetje përfituesve në gjuhën e tyre dhe ato mund ti përgjigjen pyetjeve tuaja rreth FP7. Ata janë të specializuar në çdo hap të FP7 dhe në këtë mënyrë ato sigurojnë këshillim dhe asistencë individuale për qëllimin e interesit tuaj. Sipas traditave kombëtare dhe metodologjive të ndryshme të punës, NCP kërkohen midis operatorëve të ndryshëm si ministrive, qendrave kërkuese, universiteteve, agjencive dhe kompanive private këshilluese.

Pikat e Kontaktit të Informacionit (ICP) iu japin informacion kërkuesve që vijnë nga vendet e treta dhe synojnë të marrin pjesë në kërkimin Evropian. ICP gjithashtu sigurojnë informacion për organizatat nga BE dhe vendet e asociuara, duke kërkuar për partnerë në këto vende.

Ju mund të gjeni të dhënat e kontaktit për NCP ose ICP në këto adresa interneti:

http://cordis.europa.eu/fp7/third-countries_en.html

http://cordis.europa.eu/fp7/ncp_en.html

Kapitulli III: Si të marrim pjesë?

Ky kapitull siguron informacion dhe elementët e suksesit për çdo hap të një cikli jete të projektit, nga përgatitja deri tek negociatat dhe menaxhimi.

3.1 Përgatitja e propozimit tuaj

3.1.1 Si të fillojmë?

Të marrësh pjesë në një projekt FP7 kërkohet një përgatitje e kujdesshme, më përpara se të fillojë shkrimi i propozimit.

Së pari, duhet **të keni një ide të qartë të projektit**. Hapi i parë është analizimi i thirrjes për propozimet kuptimi i tematkës. Përsa i përket përmbajtjes (përse BE vendosi të prezantojë një thirrje për propozimet për këtë temë të veçantë) është gjithashtu e rëndësishme. Ju mund të kërkoni për projektet e financuara më përpara nga BE dhe të kontaktoni Oficerin e Projektit nga BE (emrat janë të dhënë në CORDIS) të pyesë rreth origjinës së temës.

Duke ju përgjigjur pyetjeve që vijnë, mund të ndihmoheni që të përgatitni përshkrimin e projektit të pare:

- Cilat janë objektivat e kërkimit tuaj dhe objektivat teknologjikë?
- Cila është gjendja në zonën ku ju adresoheni?
- Cila është nevoja e shprehur nga përdoruesit e fundit?
- Cili është roli/pritshmëria e pritur në lidhje me tregun?
- Pse duhet ndërmarrë një kërkesë Evropiane më mirë se një kombëtare?
- Çfarë përpjekjesh duhen ndërmarrë për të arritur këto objektiva?
- Çfarë kompetencash do të kërkohen brenda konsorsiumit?

Ky përshkrim i parë do të jetë i nevojshëm si një draft fillestar i propozimit dhe si një rrugë për të prezantuar projektin tek partnerët tuaj potencialë.

3.2.1 Si të gjejmë partnerët?

a. Ku të gjejmë partnerë potencialë?

Kërkimi i parë është shfrytëzimi i rrjetit tuaj. Kërkuesit ose kompanitë që ju keni takuar gjatë kongreseve ndërkombëtare ose me të cilët ju keni punuar janë pa dyshim një pikë e mirë fillimi që të ndërtoni konsorsiumin tuaj. Gjithashtu mund të konsultoheni me Dhomën e Tregëtisë ose Agjencitë e specializuara.

Ju mund të dërgoni kërkesën e partneritetit tek Pikat Kontaktit Kombëtar FP7 (NCP) e vendeve që ju po kërkoni.

Në se juve po kërkoni një partner nga vend i tretë (as nga BE as nga vendet e asociuara) ju duhet të adresoni Pikat e Kontaktit të Informacionit (ICP) që përmbajnë gjithë të dhënat që ju interesojnë. Ju mund ti gjeni të dhënat e kontaktit në adresën e CORDIS FP7, duke zgjedhur ‘Get support’

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

Ju mundeni gjithashtu të identifikoni partnerë potencialë duke përdorur të dhëna nga adresa e Cordis. JU duhet të selektoni “find a partner” në homepage e ëebsite FP7. Duke përdorur fjalë kyçe dhe duke selektuar tipin e profilit, programin i cili është me interes për ju dhe vendin e kërkuar, ju mund të gjeni partnerë potencialë dhe detajet e kontaktit.

Një rrugë tjetër për të gjetur partnerë për projektin tuaj është të kontrollohet Support Action (një qëllim i tij është të mbikqyrë organizatat e ndryshme në një fushë të dhënë të RTD në vendet e dhëna –EU Balkan FABNet është një shembull i Support action).

Duke folur më në përgjithësi, ju mund të kontaktoni koordinatorët e partnerëve të projekteve të tanishme ose të kaluar evropinë, të lidhur me një temë të njëjtë me tuajën.

Ju mund ti gjeni gjithë projektet e kaluara dhe Support Actions në adresën e Cordis duke kërkuar “find a project” dhe pastaj duke selektuar qëllimin e interesit tuaj ose duke kërkuar emrin ose fjalëkyçin që ju kërkoni.

b. Si të procedojmë?

Ju mund të keni një **kontakt të parë informal** me telefon ose e-mail me partnerët potencialë, që ju keni identifikuar, me qëllim që të vlerësoni interesin tuaj në thirrjen për propozimet.

Në qoftë se ata janë aktualisht të interesuar, ju mund t’u dërgoni atyre një përshkrim të shkurtër të projektit dhe t’u kërkoni atyre një prezantim të kompetencave të tyre (duke përfshirë një listë të botimeve të tyre) dhe aktivitetin që ata do të implementojnë në projekt.

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

Ju mund gjithashtu t’u dërgoni një marrëveshje besueshmërie para se të shkoni më tej, me qëllim që ti siguroni me informacion më të saktë rreth projektit.

3.1.3 Si të shkruash projektin?

Propozimi është ndarë në dy pjesë:

- Pjesa A do të mbushet direkt mbi EPSS. Ajo ka të bëjë me prezantimin e përgjithshëm të projektit, të dhëna administrative të partnerëve dhe buxhetin.

HandBook “How to turn your ideas into European Projects?”

- Pjesa B përmban përshkrimin teknik të projektit: objektivat shkencorë, përparim përtej të tashmes, përshkrim të detyrave që do të kryhen dhe planifikimin e tyre, prezantimin e çdo partneri, impaktin e projektit.

Propozimi duhet të ndjekë Guidën për Aplikantët. Ju mund ta nxirrni këtë udhëzues nga adresa e CORDIS FP7, duke klikuar emrin e thirrjes, për të cilën po aplikoni (sëbashku me Programin e punës të thirrjes dhe dokumenta të tjerë, që përshkruajnë rregullat e përgjithshme të FP7).

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

Kujdes:

- Ka shumë Udhëzues për aplikantët të përshtatshëm për një thirrje. Ju duhet të merrni atë që korrespondon me skemën tuaj të financimit (Veprim mbështetës, Projekte bashkëpunuese dhe Sistem Ekselence)
- Udhëzuesi për aplikantët përshtatet gjatë thirrjes. Prandaj ju duhet të kontrolloni rregullisht nëse një version i ri është i përshtatshëm.

3.1.4 Elementët për sukses

Këshilla të përgjithshme:

- Kur shkruani propozimin duhet filluar nga objektivat: çfarë do të merret në fund të projektit? Janë gjithë partnerët në dijeni të këtyre objektivave?
- Identifikoni me saktësi rezultatet dhe novacionin.
- Të gjithë partnerët duhet të marrin pjesë në shkrimin e një propozimi, veçanërisht në përshkrimin e paketave të punës (grup detyrash), në të cilat ata janë përfshirë.
- Partnerët duhet gjithashtu të marrin një rol në përcaktimin përfundimtar të projektit: ata mund të përdorin ekspertizën e tyre të specializuar për të kritikuar ose rregulluar disa aspekte të projektit.
- Roli i çdo partneri duhet të jetë i përcaktuar qartë brenda konsorsiumit.
- Konsorsiumi duhet të demonstrojë një vlerë të shtuar të plotë, krahasuar me kapacitetet e partnerëve individualë.

Aftësia intelektuale:

Të drejtat e aftësisë intelektuale kanë rëndësi kryesore në lidhje me shfrytëzimin dhe shpërndarjen e rezultateve të projekteve të kërkimit.

Normalisht, aftësia intelektuale e zhvilluar brenda projektit, mbrohet përmes disa mjetesh, që varen nga lloji i njohurive, e reja që sjell, suksesi dhe karakteristikat strategjike të njohjes. Ai inkurajohet të konsiderojë depozitimin e një patente në Zyrën Evropiane të Patentave dhe të firmosë një marrëveshje besueshmërie me klientët, të cilët kanë nevojë të hyjnë në këtë njohuri.

Me qëllim që të shmangët çdo situatë konflikti duhet:

- Sigurohuni të adresoni gjithë botimet IPR në Marrëveshjen e Konsorsiumit
- Përpunoni të shmangni pronësinë e përbashkët të pronësisë dhe vendosni pronësi të qartë për njohurinë e krijuar në projekt. Në raste të tjera krijoni një joint-venture brenda Konsorsiumit për shfrytëzimin e pronësisë së përbashkët të njohurive
- Planifikoni si të shmangni ose minimizoni çdo konflikt të mundshëm të ardhshëm IPR brenda Konsorsiumit

Përpunimi i buxhetit:

Përpunimi i një buxheti nuk është një detyrë e lehtë, meqënëse duhet të parashikoni shpenzimet financiare në perspective, në një shkallë kohe të madhe.

Ju duhet gjithmonë të përcaktoni sa më saktë të jetë e mundur detyrat që do kryhen (programi i punës i detajuar) dhe pastaj të vlerësoni kostot e çdo detyre. Kostot janë ndarë në kosto direkte, kostot e mbulimit të personelit (rimbursim i kohës së harxhuar) udhëtime, qëndrim dhe kosto të tjera: pajisje të qëndrueshme, të konsumueshme, nënkontraktime dhe kosto indirekte. Përcaktimi i kostove indirekte varet nga skema e caktuar që do të kërkohet midis katër opsioneve të mundura (kostot indirekte aktuale, Shkalla e sheshtë (20%) dhe shkalla tranzicionale (60%). Duke identifikuar kategoritë e kostove është e rëndësishme të përgatitësh një buxhet të mirë dhe të mirë balancuar. Prandaj, kur hartoni planin e punës, duhet të identifikoni tipin e aktivitetit dhe kategorinë e koston të çdo programi pune (detyre).

Krijoni një skenar real për vlerësimin e kostove të personelit. Që ta arrini këtë filloni me pagesat reale aktuale, parashikoni përqindjen vjetore normale të rritjes së pagës dhe shtoni një përqindje të vogël.

3.1.5 Pas miratimit

Pasi projekti është pranuar, Komisioni Evropian verifikon që projekti të arrijë kërkesat administrative minimale. Propozimi është zgjedhur kur ai është i kompletuar, i plotësuar me të gjitha kërkesat minimale, në përputhje me thirrjen dhe kur kontributet e kërkuara të BE janë poshtë pragut maksimal (zakonisht 6 mln euro për një projekt bashkëpunues të madh dhe një sistem ekselence, 3mln euro për një projekt bashkëpunues të vogël dhe 1 mln euro për një veprim koordinues dhe mbështetës por kjo duhet verifikuar në çdo program pune dhe është subjekt ndryshimesh).

Propozimi vlerësohet nga një panel ekspertësh të pavarur. Ekipi vlerësues vlerëson propozimin e projektit në bazë të tre kritereve kryesore:

- Paraqitjes shkencore dhe teknologjike
- Strukturave dhe procedurave të implementimit
- Impaktit potencial të projektit

Secili nga këto kritere vlerësohet me pesë pikë ,për një total shume 15.Për secilin nga këto kërkesa propozimi duhet të arrijë të paktën tre pikë dhë me qëllim që të merret financimi shuma totale duhet të jetë të paktën 10 pikë.Zakonisht është projekti që merr shumën më të mirë që merr fondin.

Kujdes:

- Në thirrjet FP7 për propozimet ju mund të keni një ose dy hapa procedura. Në procedurën me një hap Konsorsiumi duhet të shtrojë propozimin plotësisht për vlerësim. Në procedurën me dy hapa, Konsorsiumi shtron së pari një përshkrim të projektit. Vetëm propozimet që kalojnë vlerësimin e parë ftohen t'i nënshtrohen një propozimi komplet. Procedura me dy – hapa është përdorur për Projektet e Mëdha Bashkëpunuese dhe Rrjetet e Ekselencës. Brenda temës Ushqimi,

Bujqësia, Peshkimi dhe Bioteknologjia gjenden procedurat me një dhe dy hapa. Në fund të procedurës së vlerësimit, Koordinator i projektit do të marrë një letër që përmban një Raport përmbledhës të Vlerësimit (ESR), jo vetëm që të ketë vërejtjen e marrë por gjithashtu komentet mbi forcën apo dobësinë e projektit sipas vlerësuesve. Ky raport përmbledhës vlerësues duhet parë me kujdes nga Koordinator i projektit dhe partnerët e tij, në mynyrë që të kuptojnë ose përse rezultatet ishin zhgënjyese në rast vlerësini të ulët ose që të parashikojnë cilat aspekte të projektit do të diskutohen në raundin e negociatave me Komisionin Evropian, në rast se projekti përzgjidhet.

ESR siguron vetëm një ide të radhitjes por nuk informon nëse projekti është zgjedhur për financim ose jo. Në rast sukse, Koordinator i projektit do të marrë një letër, që tregon se projekti është ftuar që të fillojë negociatat. Përndryshe përgjigja negative do të arrijë shumë më vonë.

3.2 Negocoimi i projektit

3.2.1 Si të procedohet?

- Nëqoftëse projekti juaj është zgjedhur për financim, Koordinator i projektit do të marrë një letër nga Komisioni, duke e ftuar atë të negociojë Marrëveshjen Grant. Kjo letër do të sigurojë informacion për hapin tjetër të negociatave (emri i shkencëtarit dhe financierit që do të ngarkohet për negociatat, buxhetin maksimal, skadimin për negociatat dhe komentet mbi ndryshimin e projektit). Një çelës hyrjeje në pajisjen elektronike, në të cilën informacioni i projektit do të paraqitet, është siguruar.

<https://webgate.ec.europa.eu/nef-rtd/frontoffice/login>

Koordinatori i projektit do të negociojë në emër të të gjithë partnerëve. Negociatat mund të mbulojnë shumë fusha por kryesisht këto që vijojnë:

- Buxhetin
- Detajet e përshkrimit të programit punës dhe strukturave të menaxhimit
- Konsorsiumin dhe pranimin e partnerëve të rinj

- Disa detaje administrative
- Çeshtjet IPR dhe gjithashtu disa çeshtje etike

Dokumenti që do përgatitet mund të ndahet në dy aspekte:

- **Dokumentat teknikë** (Përshkrimi i punës)

Përshkrimi i Punës është shumë i njëjtë me Pjesën B të propozimit tuaj fillestar, por ai duhet të llogaritet ESR. Kjo DoW do t'i bashkohet si aneks Marrëveshjes Grant.

- **Aspekti administrative** (marrëveshja Grant)

- Vlerësimi i pjesëmarrësit

Statusi i çdo pjesëmarrësi të FP7 shqyrtohet. Çdo pjesëmarrës regjistrohet në "Unique Registration Facility -URF" <http://ec.europa.eu/research/participants/urf> BE kontakton direkt çdo pjesëmarrës, i cili duhet të sigurojë BE me informacionin e kërkuar (kopjen e statusit ose dokument tjetër ligjor). Kur organizata nuk është një antar i BE, kërkohet përkthim në anglisht. Informacioni kërkohet vetëm një herë për gjithë zgjatjen e FP7.

- Forma e përgatitjes së Grantit (GPF)

Format kompletohen nga koordinatori, i cili ka marrë një çelës hyrje për të hyrë në website <https://ëebgate.ec.europa.eu/nef>. Koordinatorin i kërkohet çdo pjesëmarrësi të sigurojë informacion. Duhet mbushur dy seksione kryesore: informacion mbi çdo

pjesëmarrës dhe në buxhet. Informacioni për çdo pjesëmarrës mbulon fushat që vijojnë:

- Të dhëna ligjore (Emri, adresa, numri i regjistrimit dhe numri VAT)
- Statusi i organizatës (publik/privat, me përfitim/pa përfitim)
- Përfaqësuesi i autorizuar (kontakton detajet e dy personave që mund të firmosin marrëveshjen Grant)
- Kontakt (person i ngarkuar me aspektet administrative dhe shkencore)

Zgjatja e negociatave varet shume nga:

- Cilësia e propozimit tuaj
- Komentet nga ESR
- Oficeri i projektit

Ato mund të jenë shumë të thjeshta ose të komplikuar, (2 muaj) ose më gjatë (12 muaj).

3.2.2 Elementët për sukses

- Aplikimi në një program Evropian gjeneron një farë tensioni emocional. Pas intensitetit të krijimit të projektit, pranimi perceptohet si një frymëmarrje e thellë. Pastaj pritja është një proces i gjatë dhe i mërzitshëm, gjatë të cilit duhen menaxhuar shpresat. Pasi ftesa për të filluar negociatat të merret, pas një periudhe të gjatë inaktiviteti mbi projektin, procesi befas shpejtohet shumë shpejt dhe dokumentat për Marrëveshjen Grant duhen përgatitur shumë shpejt.
- Kur përgatitni propozimin tuaj në fillim, sigurohuni që keni në mendje si duket një DoW dhe çfarë ju duhet të siguroni për BE në rastin e një suksesi të propozimit tuaj. Sa më afër kërkesave të jetë propozimi juaj, aq më mirë është për propozimin dhe më të lehta do të jenë përgatitjet për negociatat.

JU mund të gjeni informacion shtesë për negociatat në Negotiation Guidance Notes në adresën e mëposhtme:

http://cordis.europa.eu/fp7/find-doc_en.html, Seksioni « Guidance documents »

3.3 Implementoni projektin tuaj

3.3.1 Rregullat bazë

Sapo faza e negociatave të përfundojë, nënshkruhet Marrëveshja Grant. Pastaj, në një datë të përcaktuar, fillon implementimi i projektit. Ai zakonisht fillon me një “kick –off meeting” të rëndësishëm, gjatë të cilit janë të pranishëm të gjithë partnerët. Kick –off meeting është i rëndësishëm, sepse ai ndihmon të sigurojë një vizion të plotë mbi objektivat e projektit.

Gjatë projektit, arrihet një procedurë e rregullt raportuese. Raportimi me BE normalisht ndodh çdo 18 muaj dhe raportimi i brendshëm çdo 6 muaj, por ai nuk është një rregull bazë. Takimet e rregullta midis partnerëve duhen organizuar për të aftësuar një ndjekje të rregullt të projektit dhe diskutimet mbi arritjet, problemet dhe aktivitetin e punës së mëtejshme.

Gjatë projektit, rreziku i menaxhimit është një çështje shumë e rëndësishme, e cila duhet planifikuar që nga fillimi i projektit. Me qëllim që të shmangim ose minimizojmë rrezikun e ndodhjes, është shumë e rëndësishme të vendosen takime të rregullta ose telekonferenca (zakonisht çdo dy ose tre muaj) midis gjithë drejtuesve të punës dhe për të përfshirë plane alternative, për të arritur detyrat dhe objektivat e ngritura.

3.3.2 Elementët për sukses

- Gjatë implementimit të projektit një çështje e rëndësishme për t’u konsideruar për suksesin e projektit është komunikimi midis gjithë partnerëve dhe në të gjithë nivelet. Jo vetëm partnerët duhet të ndihen të përfshirë në projekt sa më thellë të jetë e mundur, por Oficeri i projektit brenda Komisionit Evropian duhet gjithashtu të jetë e informuar mbi përparimin e projektit.
- Gjithë situatat e konfliktit duhen diskutuar midis partnerëve dhe një strukturë drejtimi efektive duhet ndërtuar, me qëllim që të veprohet shpejt dhe me sukses në të gjitha situatat e rrezikut.

3.3.3 Pas projektit

Një çështje e rëndësishme pas implementimit të projektit, është sigurimi i transferimit të dijeve dhe përdorimi i rezultateve të projektit. Një projekt i mirë ka një impakt pozitiv dhe domethënës në zonën e tij dhe shërben si një shembull për projektet e së ardhmes. Regjistrime financiare duhen ruajtur nga të gjithë pjesëmarrësit e projektit në rast auditit të shpenzimeve. Këto justifikime duhen ruajtur të paktën 5-vjet pas përfundimit të projektit.

Kapitulli IV: Projektet agroushqimore, propozime të përgjithshme dhe shembuj të detajuar.

Në këtë kapitull, ju do të gjeni shembuj konkretë për projektet agro-ushqimore dhe informacion të detajuar rreth BAFN dhe EU-Balkan FABNET.

4.1 Shembujt e projekteve agro-ushqimore

Projektet HP të orientuar drejt Vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë një tendencë konstante në rritje. Disa shembuj të projekteve ekzistuese janë:

Zyra e informacionit për Platformën Drejtuese për Kërkimet për Vendet e Ballkanit Perëndimor

<http://see-science.eu>

ERA West Balkan +

<http://www.westbalkanresearch.net/>

ERA West Balkan

<http://www.bit.or.at/eraeestbalkan/>

IS2Web

<http://www.is2web.org>

South Eastern Europe ERA-Net

<http://www.see-era.net/>

EU AGRI MAPPING

<http://www.agrifoodresearch.net>

JRC Initiatives for Balkans

<http://ec.europa.eu/dgs/jrc/index.cfm?id=1750&lang=en>

Balkan Agro-food Network

<http://www.europartnersearch.net/bafn/>

BAFN (Rrjeti Agro-ushqimor i Ballkanit) është një projekt i financuar me Programin Kuadër 6, me qëllimin që të nxitë kërkimin ushqimor në Vendet e Ballkanit Perëndimor. Ai ka qënë implementuar me sukses dy vitet e fundit. Konsorsiumi i projektit mbledhi 13 organizata nga 8 vende, midis të cilëve 4 WBC (Shqipëria, Bosnia dhe Hecegovina, Serbia, Montenegro dhe FYROM)

Objektivi i përgjithshëm i projektit ishte mbështetja e hapjes së Zonës së Kërkimit Evropian, duke zhvilluar një rrjet të qëndrueshëm në sektorin bujqësor dhe ushqimor në Ballkanin Perëndimor.

Drejtimit kryesore të projektit ishin:

- *Një database kërkimi dhe një database për kompani*

Databases janë një vegël, që synon të kontrollojë ndërtimin e sistemeve midis organizatave bujqësore dhe ushqimore nga WBC dhe organizatave ushqimore nga BE. Ai u projektua të ndihmojë kërkuesit, qendrat e kërkimit dhe kompanitë për të filluar bashkëpunimin me të tjerët dhe të identifikonte shkencëtarët ose organizatat me kompetenca specifike. Këto të dhëna janë të përshtatshme on line në portalin e BAFN.

- *A raport-hartë*

Katër raporte kombëtare harta synojnë të identifikojnë potencialin kërkues në fushën e kërkimit bujqësor dhe ushqimor në çdo Vend të Ballkanit Perëndimor të mbuluar nga projekti BAFN. Raportet përfshijnë të dhëna mbi organizatat (tipi i organizimit, masa mesatare, prodhimi dhe produktiviteti) dhe mbi shkencëtarët (niveli dhe sektori i edukimit, mosha, gjinia etj.

Një raport i tillë i konsoliduar, identifikon lojtarët kryesorë në kërkimin bujqësor dhe ushqimor dhe në industri.

- *Rekomandime mbi zonat e kërkimit dhe instrumentat mbështetës*

Një raport sintezë u hartua duke identifikuar situatën e tanishme dhe nevojat për të ardhmen të kërkimit ushqimor të Ballkanit perëndimor. Raporti përfshin një listë të fushave kryesore, të konsideruara si zona prioriteti për kërkimin bujqësor dhe ushqimor në çdo vend. Ai gjithashtu përmban një përshkrim të mekanizmave mbështetës që kontribuojnë në përgjigjen e problemeve të veçanta të kërkimit dhe industrisë në Vendet e Ballkanit Perëndimor.

4.2 Cilat janë objektivat e EU-Balkan-FABN dhe grupet target

EU-Balkan-FABNET (<http://www.balkan-fabnet.eu>) është një veprim mbështetës i veçantë, i financuar nën temën “Cilësia dhe siguria e ushqimit” të programit kuadër 6 të BE. Ai synon rritjen e pjesëmarrjes të kërkuesve nga Ballkani Perëndimor në projektet kërkuese ushqimore të Programit Kuadër 7 të BE (FP7).

Aktivitetet kryesore që do të kryhen nga konsorsiumi janë:

- Listimi i kërkuesve të sektorit FAFB në Ballkanin Perëndimor dhe mundësitë e financimit lokal për mbështetjen e bashkëveprimit ndërkombëtar të kërkimit
- Trainimi i shumëfishuesve/përhapësve të informacionit përmes Ballkanit Perëndimor mbi çeshtjet që mbulon FP7 dhe karakteristikat e saj si dhe praktikat më të mira në ngritjen dhe shpërndarjen e dijes.
- Trainimi i kërkuesve të Ballkanit Perëndimor mbi çeshtjet që mbulojnë FP7 dhe karakteristikat e saj, praktikat e propozimeve dhe pjesëmarrja etj.
- Ngritja e profilit dhe rrjetit të kërkuesve përmes pjesëmarrjes së tyre në çeshtjet shkencore ndërkombëtare ose të rrjetit.

- Mbështetje e vazhdueshme në përfshirjen e FP7 dhe shërbimeve të kërkimit partner, sipas nevojave të kërkuesve individualë.
- Ngritja profilit dhe informacionit përmes rrjetit të internetit, një manual FP7 dhe dokumenta të rregullta.
- Projekti veçanërisht synon kërkues dhe grupe kërkimi nga vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe kompani lokale me qëllim që të rritë nivelin e dijeve dhe të mundësive për financim të BE dhe të futë më tej kërkuesit e EBC në kërkimin Evropian.

4.3 Partnerët e projektit EU-Balkan-FABN

EU-Balkan-FABN është krijuar nga 11 partnerë, nga të cilët 6 nga Vendet e Ballkanit Perëndimor dhe 5 nga shtetet antare të BE

Të gjithë partnerët kane eksperiencë në projektet bashkëpunuese Evropiane. Ato mbajnë një rrjet të zgjeruar kontaktesh me komunitetin kërkues lokal dhe synojnë të ndihmojnë aktorët lokalë FAFB drejt një përfshirjeje më të lartë në iniciativat bashkëpunuese ndërkombëtare.

Konsorsiumi EU-Balkan-FABNET është si vijon:

Greqi: Kompania e Kërkimit Industrial të Ushqimit dhe Zhvillimit Teknologjik
ETAT S.A.

<http://www.etat.gr>

Shqipëria: Agjencia e Zhvillimit Ekonomik të Qendrueshëm
SEDA

<http://www.seda.org.al>

Mali i Zi: Agjencia për Bashkëpunim Ndërkombëtar Shkencor, Edukues, Kulturor dhe Teknik

AISC

<http://www.gom.cg.yu/zamtes>

HandBook “Hoë to turn your ideas into European Projects?”

Universiteti i Beogradit, Fakulteti i Bujqësisë
UNIBEL

<http://www.agrifaculty.bg.ac.yu>

Universiteti i Shkupit Ss. Cyril dhe Methodius, Fakulteti i Shkencave Bujqësore
Yugoslave dhe Ushqimit, Republika e Maqedonisë
CMU

<http://www.ukim.edu.mk/index.php?lan=en&pon=clenki>

Bosnia dhe Universiteti i Sarajevos, Fakulteti i Bujqësisë dhe Shkencave të Ushqimit,
Sarajevo

UNISAR

<http://www.ppf.unsa.ba>

Kroaci Ministria e Shkencës, Edukimit dhe Sporteve, Drejtoria për Bashkëpunim
Ndërkombëtar

MSES

<http://www.mzos.hr>

Agjencia për Nxitje të Kërkimit Evropian

APRE

<http://www.apre.it>

France Euroquality

EQY

<http://www.euroquality.fr>

Belgjikë Agjencia e Ndërmarrjes Bruksel

BEA

<http://www.bea.irisnet.be>

Serbia

Herzegovina

Italy

Bulgaria EuroProject

EP

<http://www.europroject.bg/>

Shtesë

A.1 Terminologji

Vendet kandidatë të asociuara (ACC)

Për të ndjekur një marrëveshje bashkëpunimi shkencor dhe teknologjik për të marrë pjesë në FP7, ACC ka të njëjtin status si partnerët nga 27 vendet antare të BE. Midis tyre është Turqia, FYROM, Serbia, Kroacia, Mali i zi, Shqipëria dhe Bosnja - Hercegovina

Thirrja për propozimet

Ato botohen nga Komisioni Evropian dhe paraqesin një ftesë të hapur për të shkruajtur një propozim kërkimi, që drejton Programin e punës. Ato zyrtarisht botohen në Gazetën zyrtare të BE si dhe në adresën e internetit të Cordis.

Projektet bashkëpunuese

Projektet bashkëpunuese paraqesin një mbështetje për projektet kërkuese, të kryera nga konsorsiumi me pjesëmarrës nga vendet e ndryshme, duke synuar në zhvillimin e njohurive të reja, teknologjive të reja, produkteve, aktiviteteve demonstruese ose burimeve të përgjithshme për kërkim. Zgjatja e punës përfshihet midis 18 dhe 48 muaj. Projektet radhiten nga aksione kërkimi të vogla ose mesatare në projekte të integruar në shkallë të madhe, për të arritur një objektiv të përcaktuar. Projektet duhet gjithashtu të synojnë grupe të zgjedhura si: SME dhe aktorë të tjerë më të vegjël.

Kërkimi komunitetit dhe Shërbimi i zhvillimit të informacionit (CORDIS)

Cordis është [website](http://cordis.europa.eu/fp7/home_en.html) zyrtar dhe database i FP7. Ju mund të gjeni gjithë informacionin që ju nevojitet lidhur me projektet FP7 dhe propozimet, në [webpage](http://cordis.europa.eu/fp7/home_en.html) që vijon:
http://cordis.europa.eu/fp7/home_en.html.

Konsorsium

Një konsorsium është një grup organizatash (p.sh.qendra kërkimi, universitete, organizata qeveritare dhe jo qeveritare, shoqata konsumi dhe industrie, SME, kompani private) që punojnë sëbashku si partnerë në një projekt FP7.

Marrëveshja e konsorsiumit

Marrëveshja e konsorsiumit është një dokument që finalizohet midis partnerëve, që i lejon ato të përcaktojnë në detaje parashikimet administrative dhe drejtuese që të kryejnë projektin e tyre.

Koordinimi dhe Veprimet Mbështetëse

Aksionet koordinuese dhe mbështetëse synojnë që të kordinojnë dhe mbështesin aktivitetet dhe politikat kërkuese (rrjetet, shkëmbimet, hyrjet trans-kombëtare në infrastrukturën kërkuese, studimet, konferencat). Këto veprime nuk synojnë të prodhojnë një

rezultat tangjent në kuptimin e inovacionit, por të bëjë një mbikqyrje të burimeve Evropiane ekzistuese në një fushë të dhënë ose të asistojë implementimin e FP7.

EPPSS - Sistemi Elektronik i Mbajtjes së Propozimit

Gjithë propozimet kërkuese duhen dërguar tek Komisioni në një version elektronik. EPSS paraqet një paisje on-line, që të përgatitë dhe pranojë një propozim projekti FP7. Është e detyrueshme të përdoret ky sistem elektronik, me qëllim që të pranohet propozimi juaj.

ERA - Zona Kërkimit Evropian

ERA është një koncept për të nxitur lëvizjet e lira të njohurive, teknologjisë dhe kërkuesve, duke krijuar një treg të brendshëm Evropian real për kërkuesit. Ai synon në strukturimin dhe koordinimin e politikave dhe aktiviteteve kombëtare të kërkimit, me idenë finale të zhvillimit të një politike kërkimi Evropiane të përbashkët.

Projektet FP7 janë një instrument për të mbështetur arritjen e objektivave të ERA.

EU-Balkan-FABNet

EU-Balkan-FABNET është një aksion me mbështetje të veçantë, i financuar nga BE, që synon në rritjen e pjesëmarrjes së kërkuesve nga Ballkani Perëndimor në projektet kërkuese të FP7. Projekti siguron asistencë të drejtpërdrejtë, me vlerë të shtuar për kërkuesit dhe shumëfishuesit e informacionit. Ai fokusohet në trainimin dhe rritjen e bashkëpunimit në aktivitetet kërkuese, në temat e Ushqimit, Bujqësisë, Peshkimit dhe Bioteknologjisë të FP7.

Shtetet antare të BE

Vendet e BE janë: Austria, Belgjika, Bullgaria, Qipro, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksenburg, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Slovenia, Spanja, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar.

FP7-Programi i shtatë kuadër për Zhvillimin e Kërkimit dhe Teknologjisë

Programet kuadër, që nga viti 1984, përbëjnë mjetin financiar kryesor, përmes të cilit BE mbështet aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit, që mbulojnë pothuaj gjithë disiplinat shkencore. Sot FP7 paraqet instrumentin kryesor për financimin e kërkimit në Evropë dhe zgjat nga 2007 deri 2013. Buxheti total vlerësohet për shtatë vjetët e tjerë 50.5 bilion Euro.

Pikat e kontaktit të informacionit (ICPs)

ICPs janë stabilizuar në vendet e treta të BE. Ato sigurojnë shërbime informacioni të specializuar për të ndihmuar kërkuesit në kërkimin Evropian. Mbështetja e siguruar është e njëjtë me mbështetjen e NCPs në vendet antare dhe vendet e asociuara dhe duhet të jenë pika e parë e kontaktit në se doni informacion mbi FP7.

Vendet partnere të bashkëpunimit ndërkombëtar

ICPC janë vendet me të ardhura të ulta, me të ardhura mesatare të ulta dhe të ardhura mbi mesataren, të synuara nga Komisioni Evropian për të rritur bashkëpunimin e kërkimit.

Organizatat nga këto vende marrin pjesë në projektet FP7 dhe marrin para nga FP7, duke u siguruar që kushtet minimale sigurohen.

Pikat e kontaktit kombëtar (NCP)

NCPs janë struktura të stabilizuara në nivel kombëtar dhe të financuara nga qeveritë e 27 vendeve antare dhe vendeve të asociuara të FP7. NCPs sigurojnë mbështetje individuale dhe në gjuhën e vetë propozuesve.

NCP marrin pamje/forma të ndryshme sipas traditave kombëtare dhe metodologjisë së ndryshme. Ato mund të paraqiten nga operatorë të shumtë, të tillë: si organizatat e asociuara dhe të industrisë, universitetet, qendrat e kërkimit, ministritë, agjencitë e specializuara ose kompanitë private.

Në se keni ndonjë pyetje rreth FP7, projekte ose thirrje ose doni të gjeni një partner, NCPs do të jetë pika e parë e informacionit që duhet kontaktuar.

Sistemet e Ekselencës

Sistemet e ekselencës mbështesin bashkëveprimin midis qendrave të kërkimit, të specializuara në një fushë të dhënë. Ato synojnë në integrimin dhe ndarjen e njohurive shkencore në nivel Evropian.

Kërkimi i partnerit

Me qëllim që të marrin pjesë në Kërkimin Evropian, në shumicën e rastit ju nevojitet lehtë të gjejsh partnerin më të përshtatshëm brenda rrjetit tuaj.

Për të mbështetur dhe lehtësuar ndërtimin e një Konsorsiumi të fortë, CORDIS si dhe NCPs ose ICPs, si dhe një numër projektesh të tjera Evropiane ju ndihmon të gjeni partnerë.

Potenciali i kërkimit

Potenciali i kërkimit është zona e FP7, e cila synon nxitjen e realizimit të potencialit të plotë të kërkimit të BE, duke çbllokuar dhe zhvilluar potencialin kërkues ekzistues ose që del në zonat e konvergencës të BE (GDP e të cilëve është më pak se 75% e GDP mesatare të BE 27) dhe duke ndihmuar të forcojë kapacitetet e kërkuesve të tyre që të marrin pjesë me sukses në aktivitetet kërkuese të BE.

Ndarë në tre pjesë, i treti ka të bëjë me bashkëpunimin ndërkombëtar, duke siguruar kështu mundësinë që të zhvillohet partneriteti përmes aksioneve me qendrat kërkuese ekzistuese apo që dalin në Vendet antare dhe ato të Ballkanit Perëndimor.

Në këtë kontekst, një thirrje e re për propozimet, do të hapet në 2009.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME)

Një SME është një biznes tregëtar i pavarur, që përfshin jo më shumë se 250 puntorë dhe që ka më pak se 50 milion Euro në të ardhurat vjetore. Përcaktimet dhe kërkesat e klasifikimit për SME jepen në Rekomandimin e Komisionit 2003/361/EC.

Vendet e treta

Vendet e treta janë gjithë vendet të cilat nuk janë shtete antare të BE dhe jo vende të asociuara. Në parim ato mund të marrin pjesë të gjitha në projektet FP7 por vetëm ICPC mund të marrin fonde nga BE.

Programi i punës

Programi individual i punës konsiston në plane implementimi të detajuara për temat e kërkimit të programeve të veçanta dhe aktiviteteve të tjera nën FP7. Ato specifikojnë objektivat konkrete shkencore, teknike, ekonomike dhe shoqërore të çdo aktiviteti, duke siguruar një formim të gjerë dhe mbështetje teknike të detajuar.

Ato projektojnë një “hartë rruge” të thirrjeve të planifikuara për propozimet dhe gjithashtu tregojnë për çdo thirje instrumentat që do të jenë të përshtatshëm dhe kriterin e vlerësimit që do të aplikohet.

A.2 Adresa të përdorshme

Më tepër informacin gjendet në websitet që vijojnë:

FP7 on CORDIS

http://cordis.europa.eu/fp7/home_en.html

Research and Innovation on the Europa server:

http://europa.eu/pol/rd/index_en.htm

DG Research

http://ec.europa.eu/research/index_en.cfm

Biosociety website

http://ec.europa.eu/research/biosociety/index_en.htm

EU-Balkan FABNet

<http://www.balkan-fabnet.eu/>

BAFN

<http://www.europartnersearch.net/bafn/>

EU-BALKAN-FABNet Page 53 of 53